



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.307/1 prot.

Tiranë më 17.3.2023

Lënda: Kthim përgjigje tuajës me nr. 307 prot., datë 07.02.2023.

QENDRËS “QËNDRESA QYTETARE”

Tiranë

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), është depozituar shkresa juaj administruar me tonën me nr. 307 prot., datë 07.02.2023, përmes së cilës referoni disa shqetësime për përpunim të paligjshëm të të dhënave personale, si dhe shkelje të detyrimeve të parashikuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji”), nëpërmjet aplikacionit “AktivIst”.

Fillimisht, dëshirojmë të vlerësojmë sensibilitetin tuaj për të sjellë në vëmendje respektimin e detyrimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat synojnë ruajtjen e dinjitetit njerëzor, duke garantuar të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, të parashikuar në nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Njëkohësisht, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 35 të saj, e ka parashikuar mbrojtjen e jetës private dhe të dhënave personale si një nga liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Zbërthimi mëtejshëm i kësaj të drejte themelore dhe përcaktimi i rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, gjen rregullim të posaçëm në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim “Ligji 9887”), dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

Mbas publikimit përmes mediave të informacioneve për përpunimin e të dhënave personale që kryhet në këtë aplikacion, Zyra e Komisionerit e ka marrë në shqyrtim këtë platformë, edhe më herët, duke bërë një analizë paraprake, në cilësinë e autoritetit publik të pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale.

Vlerësimi i Zyrës së Komisionerit në lidhje me këtë platformë është mbështetur në analizën që i është bërë strukturimit të këtij aplikacioni, të dhënave personale që përpunohen përmes tij, përputhshmërisë së proceseve përpunuese, në raport me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, si dhe respektimit të detyrimeve të sanksionuara në legjislacionin kombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Lidhur me shqetësimet e ngritura dhe sensibilitetin për respektimin e disa prej kërkesave kryesore të Ligjit si: Garantimi i pëlqimit të subjekteve të të dhënave, si një nga kriteret ligjore bazë për përpunimin e të dhënave personale si dhe përmbushjen e detyrimit për informim ndaj subjekteve të të dhënave personale, ju bëjmë me dije se janë trajtuar nga ana jonë, duke bërë analizën dhe vlerësimet përkatëse, sipas përmbajtjes në vijim.

Nga verifikimet që janë kryer rezulton se, Aplikacioni “*Aktiv1st*”, gjendet si në Google Playstore, po ashtu edhe në APP STORE, dhe mund të shkarkohet nga klientët e këtyre platformave. Sipas informacionit që jepet për aplikacionin, ndër të tjera, detajohet se, aplikacioni “*Aktiv1st*” ka për qëllim që: *“Ti japë mundësinë çdo personi që ka ide dhe dëshirë, të jetë pjesëmarrës në gara lokale ose kombëtare, të çojë përpara nismat e tij, si dhe të jetë një faktor aktiv në komunitetin ku jeton”*.

Evidentohet se, përdoruesi përpara se të vijojë me instalimin dhe përdorimin e aplikacionit, duhet të pranojë **“Kushtet e Përdorimit”**, në përmbajtje të së cilës informohet subjekti i të dhënave se: *“Duke u regjistruar në platformën e aktivistit ju jeni dakord me kushtet e përdorimit dhe ju jepni pëlqimin/miratimin tuaj për përdorimin e të dhënave personale të cilat do të përpunohen në përputhje të plotë me përcaktimet e ligjit 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”*. Pra, përpara se përdoruesi të regjistrohet në mënyrë përfundimtare në këtë aplikacion duhet të jap pëlqimin për **“Kushtet e Përdorimit”**.

Në këtë kuadër, lidhur me sensibilitetin për garantimin e pëlqimit të dhënë lirisht nga subjektet e të dhënave personale, që behën pjesë e këtij komuniteti virtual, konstatojmë se, përdoruesi ka mundësinë që të njihet me Politikën e Privatësisë së këtij aplikacioni, në rubrikën Informacione *“Data safety”*, në sesionin *“Security practices”*, dhe çdo veprim i mëtejshëm për shkarkimin dhe përdorimin e tij, është tërësisht në vullnetin e lirë të vetë përdoruesit.

Më tej, nga shqyrtimi i të dhënave teknike dhe të përgjithshme në Google Play, rezulton se, PlayStore informon çdo përdorues mbi disa funksionalitete të aplikacionit. Në rubrikën *“Data Safety”*, jepet një përshkrim i përgjithshëm se si zhvilluesi i aplikacionit, mbledh dhe ndan të dhënat e përdoruesve. Gjithashtu, në rubrikën Informacione *“Data safety”*, në sesionin *“Security practices”*, mund të shikohet rubrika *“Politika e Privatësisë”* së zhvilluesit të aplikacionit, përmes së cilës i jepet mundësia kujtdo që dëshiron të shkarkojë këtë aplikacion, që të ketë informacion paraprak mbi përpunimin e të dhënave personale përmes kësaj platforme. Ky sesion informues i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi proceset përpunuese, përpara se të marrin vendim për shkarkimin ose jo të këtij aplikacioni.

Në këtë kuadër, nga verifikimet, është konstatuar se zhvilluesit e kësaj platforme e kanë strukturuar këtë rubrikë “Politika e Privatësisë” në mënyrë që subjekti i të dhënave të ketë një informacion paraprak mbi përpunimin e të dhënave personale, përpara marrjes së vendimit përfundimtar për t’u bërë pjesë e kësaj platforme.

Lidhur me respektimin e parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave, dhe qëndrimin se grumbullimi i disa të dhënave përmes këtij aplikacioni (*të tilla si: vendbanimi, vendqëndrimi, adresa e banimit*) është tërësisht jo propocional, vlerësojmë se argumentimi mbi këtë pikë, vjen në linjë me analizën e bërë më sipër mbi pëlqimin dhe informimin e subjekteve të të dhënave. Në kushtet kur subjektet e të dhënave bëhen pjesë e këtij aplikacioni duke u regjistruar në mënyrë vullnetare, atëherë përpunimi i këtyre të dhënave më tej konsiderohet në përputhje me kriterin ligjor të parashikuar në nenin 6, pika 1/a (*Të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin*).

Sa i takon shqetësimin që është ngritur edhe më herët mediatikisht, në lidhje me ushtrimin e presionit ndaj nëpunësve të administratës shtetërore apo urdhërimit e tyre nga eprorët, në mënyrë të paligjshme, për shkarkimin e këtij aplikacioni, vlerësojmë t’ju bëjmë me dije se Zyra e Komisionerit nuk ka administruar asnjë ankesë nga vetë subjektet e të dhënave. Megjithatë, në çdo rast verifikimi dhe marrja e masave në këtë kuadër, është tërësisht jashtë kompetencave ligjore të Zyrës së Komisionerit. Kuadri ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ka parashikuar një sërë instrumentash të tjerë që mund të shfrytëzohen për t’u ankuar ndaj urdhrave të paligjshëm të eprorëve të institucioneve, (*Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kodit i Punës së Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, etj*).

Së fundi, Zyra e Komisionerit mbetet plotësisht e angazhuar për të ndjekur me vëmendje rastet e përpunimit të të dhënave personale nga të gjithë kontrolluesit dhe përpunuesit, me qëllim identifikimin e rasteve të cilat shkelin detyrimet ligjore të sanksionuara në legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale.

Duke ju falënderuar,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi